



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit
P- 08
Prishtinë, më 7 prill 2011

PROCES\VERBAL

**IMBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 7 PRILL 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 101 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme plenare, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të grupit të deputetëve.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe
2. Rezoluta ne mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes në mes të z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar me 6 prill 2011

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 27 të Rregullores së Kuvendit, candidate për Presidente të Republikës së Kosovës janë nominuar, znj. Atifete Jahjaga, aktualisht ndihmës drejtore në Policinë e Kosovës, për kandidaturën e së cilës kanë nënshkruar 41 deputetë, ndërsa

kandidatja tjetër është deputetja Suzana Novoberdaliu, për kandidaturën e së cilës kanë nënshkruar 31 deputetë të tjerë.

Ai kërkoi nga propozuesit që para deputetëve të Kuvendit të paraqesin arsyetimin për kandidatet e nominuara për Presidente.

Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, në emër të grupit të deputetëve paraqiti arsyetimin për kandidatet e nominuara për presidente.

Në vazhdim, kryetari propozoi që për verifikimin e kushteve të kandidateve të nominuara për presidente, Kuvendi të autorizojë Nënkomisionin për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit, në këtë përbërje:

1. Armend Zemaj, kryetar, GP LDK;
2. Behar Selimi, zëvendëskryetar, GP PDK;
3. Albulena Haxhiu, anëtare, GP “Vetëvendosje”;
4. Ardian Gjini, anëtar, GP AAK;
5. Ibrahim Makolli, anëtare, GP Koalicioni për Kosovë të Re;
6. Jasmina Zhivković, anëtare GP SLS, dhe
7. Mufera Shinik, anëtare, GP “6+”.

Kryetari kërkoi nga deputetët që përmes një votimi formal të deklarohen për autorizimin e këtij komisioni.

Deputetët miratuan me shumicë votash propozimin e kryetarit që Kuvendi që të autorizohet Nënkomisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit për verifikimin e kushteve të kandidateve të nominuara për presidente.

Armend Zemaj, në emër të këtij komisioni, para Kuvendit paraqiti Raportin dhe konstatoi se kandidatet për presidente i plotësojnë të gjitha kushtet, të parapara me dispozitat ligjore për President të Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi debatin lidhur me propozimin e grupeve të deputetëve, për kandidatet për President të Republikës së Kosovës.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së përkrahu kandidaturën e Atifete Jahjagës për Presidente të Republikës së Kosovës.

Vjosa Osmani, në emër të GP të LDK-së përkrahu kandidaturën e Atifete Jahjagës për Presidente të Republikës së Kosovës.

Visar Ymeri, në emër të lëvizjes “Vetëvendosje” nuk e përkrahu kandidaturën e Atifete Jahjagës për Presidente të Republikës së Kosovës.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së konstatoi se si grup parlamentar do të jenë në sallë gjatë procesit të votimit.

Ibrahim Makolli, në emër të Koalicionit Kosova e Re tha se e mbështesim Marrëveshjen në mes të z.Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Sasha Rashiq, në emër të GP të SLS përkrahu kandidaturën e Atifete Jahjagës për Presidente të Republikës së Kosovës.

Rasim Demiri, në emër të GP “6+” përkrahu kandidaturën e Atifete Jahjagës për Presidente të Republikës së Kosovës.

Kryetari, më tutje i njoftoi deputetët lidhur me procedurën për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, ai ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet Parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. Berat Buzhala, GP PDK,
2. Armend Zemaj, GP LDK,
3. Jeton Sfirca, GP Koalicioni Kosova e Re,
4. Jelena Bontiq, GP SLS,
5. Duda Balje, GP “6+” .

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Ndërkohë, GP i Lëvizjes “Vetëvendosje” e lëshoi sallën.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, Raportin e paraqiti Berat Buzhala. Ai konstatoi se në votim morën pjesë 100 deputetë dhe rezultati i votimit është si në vijim:

- Për Atifete Jahjagën votuan 80 deputetë.
- Për Suzana Novoberdaliun votuan 10 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 10 fletëvotime.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me dy të tretat (2/3) e votave mori këtë

V E N D I M

Për zgjedhjen e Presidentes së Republikës së Kosovës

1. **Atifete Jahjaga**, zgjedhet Presidente e Republikës së Kosovës.
2. Mandati i Presidentes është pesë (5) vjet.

Kryetari ftoi Presidenten e sapo zgjedhur të Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, të japë betimin dhe për një fjalë rasti.

Pas dhënies së betimit, Presidentja mbajti një fjalë rasti.

Presidentja **Atifete Jahjaga**, në fillim falënderoi deputetët për besimin e dhënë dhe tha se zgjedhja ime presidente shpreh qëndrimin konsensual për gjetjen e zgjidhjes, e cila do të ndikojë në të mirën e vendit dhe në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme kushtetuese, që kanë të bëjnë me zgjedhjen e presidentit.

Ajo tha se jam e gatshme të shërbej ashtu siç më thërret vendi im, ashtu siç e kam bërë këtë edhe në kuadër të Policisë së Kosovës gjatë dekadës së kaluar, por jam edhe krenare që jam angazhuar në krijimin e Policisë së Kosovës dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, Presidentja Jahjaga detyrën e presidentes e vlerësoi si më sfiduesen në karrierën e saj, ndërsa shfaqti besimin në qytetarët e Kosovës dhe në Qeverinë e vendit se do të përmbushim objektivat tona, tha se do të jetë faktor unifikues dhe përfaqësues e të gjithë qytetarëve, pa dallim kombi, gjinie, feje, etj.

Në rrafshin e brendshëm do të angazhohem për sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, drejt proceseve integruese dhe do ta mbaj të gjallë idenë e lirisë dhe të demokracisë ndërmjet popujve dhe se një ditë ëndrrat tona do të bëhen realitet.

Presidentja, lidhur me bashkëpunimin rajonal tha se Kosova është një faktor stabiliteti dhe në këtë kontekst i vlerësoi edhe bisedimet Kosovë – Serbi, të nisura kohë më parë, për të cilat tha se ato do të kenë sukses, qytetarët e të dy vendeve do t'i kthehen jetës normale dhe nga këto bisedime shpreson se do të fitojnë të gjithë. Ndërsa, në aspektin e pozicionit ndërkombëtar të vendit tonë, ajo konstatoi se do t'i vendosim mjetet diplomatike dhe do të angazhohet që Republika e Kosovës të bëhet sa më parë anëtare e OKB-së.

Ndërkaq, duke folur për reformat në fusha të ndryshme, si në arsim, drejtësi, ekonomi, etj ajo tha se kjo gjë është e mundur vetëm duke e rritur cilësinë, ndërsa lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës tha se ne duhet sa më parë ta arrijmë këtë dhe se Kosova nuk mund të mbetet prapa vendeve të rajonit në procesin e integriteteve evropiane.

Në fund, presidentja siguroi qytetarët e vendit se në punën e saj do të udhëhiqet nga Kushtetuta e vendit, ligjet në fuqi dhe se do të përfaqësojë denjësisht interesat e tyre dhe të shtetit të Kosovës.

2. Rezoluta në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z.

Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupet parlamentare të AKR-së, të LDK-së dhe të PDK-së kanë proceduar në Kuvend Propozim-Rezolutën në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Në emër të tri grupeve parlamentare të lartpërmendura, tekstin e Projekt-rezolutës e lexoi deputeti Ibrahim Makolli.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë këta deputetë: Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, Arsim Bajrami dhe Rasim Demiri.

Kryetari, më pas hodhi në votim Propozim-Rezolutën në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, të nënshkruar më 6 prill 2011.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për-----75,
Kundër----- 0,
Abstenim ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nxori këtë:

REZOLUTË

Në mbështetje të Memorandumit të Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkrahjen e tij për Memorandumin e Marrëveshjes ndërmjet z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi (më tej Memorandumi), të arritur më 6 prill 2011, dhe mbështet plotësisht zotimet e përmbajtura në të.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të legjislacionit të ndërlidhur, në mënyrë që Presidenti i Republikës së Kosovës të zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kuvendi mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum, sipas të cilit zgjedhjet e para presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe legjislative hyjnë në fuqi. Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit, i identifikuar nga koalicioni qeverisës për këtë qëllim, ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 6-9 muajsh nga data e themelimit.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet zotimet dhe afatet kohore të përmbajtura në Memorandum që kanë të bëjnë me nevojën për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe të legjislacionit të ndërlidhur, që mes tjerash do të përkrahin krijimin e më shumë distrikteve zgjedhore në Kosovë. Kuvendi mbështet themelimin e një komisioni, të udhëhequr nga një deputet i Kuvendit, i identifikuar nga partitë opozitare për këtë qëllim, ashtu siç është paraparë në Memorandum. Në pajtueshmëri me Memorandumin, Komisioni do të synojë të kryejë punën e vet brenda 8-12 muajsh nga data e themelimit.

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet afatin kohor të përmbajtur në Memorandum, sipas të cilit zgjedhjet e para të përgjithshme në Kosovë sipas Ligjit të amandamentuar për zgjedhjet e përgjithshme do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet themelimin e komisioneve të lartpërmendura, të nevojshme për proceset kushtetuese dhe legislative në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e jashtëzakonshme plenare në orën 20:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale